



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.14/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) me seli në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të nominimeve të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si e palejuar ankesa** Anr.14/2017 i subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) e datës 26.05.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 26.05.2017, ka pranuar ankesën Anr.14/2017 nga subjekti politik PDAK me të cilën pretendon se subjekti politik në fjalë i plotëson kushtet për emërimin e anëtarëve të KVV-së sipas rregullës Zgjedhore të KQZ-së 19/2016. Parashtruesi i ankesës kërkon që nominimet për KVV nuk duhet të ndahen në mes të subjekteve politike PDAK, PAI dhe PLE pasi që subjekti politik PDAK ka me shume vota se subjektet tjera politike si PAI dhe PLE dhe se subjekti politik PDAK ka pasur përfaqësues në asamblenë Komunale të Ferizajt

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se ankesa është e palejuar sepse KQZ-ja në kohën e caktuar i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore që ti dorëzojnë propozimet e tyre në KKZ për personat që dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunave të tyre duke zbatuar rregullat zgjedhore.

Andaj mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se nominimet për anëtar të KVV nuk janë bërë në mënyrë të drejtë nuk qëndrojnë pasi që KQZ deri me tani ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017. Prandaj mbi këtë bazë paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar për tu parashtruar.

Andaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 14/2017 më datën 26.05.2017.



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.